



LISTA KONTROLLUESE PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TË PUNËS PËR PUNËDHËNËS

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.6.	RREZIQET QË LIDHEN ME AKSIDENTET NË PUNË
Nën – tema 2.6.7.	MBROJTJA NGA ZJARRI
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Ligji Nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri; • Ligji Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë; • Rregullore Nr.08/2013 për Përbajtjen dhe Procedurat e Hartimit të Planeve të Reagimit Emergjent; • Rregullore Nr.24/2012 për normat teknike për mbrojtje nga zjarri të objekteve të larta; • Rregullorja (MPMS) Nr.02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës; • Udhëzimi Administrativ Nr.17/2017 për testimin dhe servisimin e aparateve për fikje të zjarrit; • Udhëzim Administrativ Nr.24/2012 për rrjetin e hidrantave për fikjen e zjarrit;
Shkurtesa:	• MPB - Ministria e Punëve të Brendshme • MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale • AME - Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave • UA - Udhëzim Administrativ • SSHP - Siguri dhe Shëndet në Punë • PPM - Pajisjet Personale Mbrojtëse
Përdorimi i listës kontrolluese	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje se mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Koment për zbatimin
	KONTROLLIMI I DOKUMENTEVE / NË ZYRË			
	* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me të/ata. * Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve. * Sqaroni dhe këshillojini për detyrimet që obligoheni në përmirësimin e situatës së sigurisë në vendin e punës.			

	<i>* Përfundoni takimin duke dhënë një rekomandim përfundimtar të sigurisë dhe fushat për përmirësim.</i>			
1.	A janë marr masat për mbrojtje nga zjarri në përputhje me planin e mbrojtjes nga zjarri? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 8. Rregullore 08/2013 neni 4, 5, 26, 27. - A është bërë kategorizimi i rrezikshmërisë nga zjarri për objektet, pjeset e objekteve dhe mjedisin? (Së bashku me stafin përmbledhet dokumentacioni i nevojshëm dhe përkatës që e verifikon dhe vërteton se cilës kategori i takojnë objektet të cilat duhet të jenë të kategorizuar, nëse kategorizimi nuk është bërë për të gjitha objektet dhe mjedisin, mirret veprimet e nevojshme për kategorizim). - Për kategoritë e vlersuara (I, II, III, IV), a është hartuar plani i mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë, a janë formuar njësitë e mbrojtjes nga zjarri me kuadro të nevojshëm dhe mjetet e domosdoshme për punë për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri? (Në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë siguroni që të caktohet njësia e mbrojtjes nga zjarri, siguroni mjetet e nevojshme, dhe kuadro i cili do të obligohet me këtë qështje). - A është bërë plani në harmonizim me planin komunal për mbrojtje nga zjarri për kategorinë (I & II). (Sigurohuni që plani i mbrojtjes nga zjarri është i harmonizuar me planin komunal). - A është përcaktuar të paktë një puntorë të cilit i është ofruar trajnimi përkatës dhe kujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri. (Siguroni që punëtori i përcaktuar të ndjek trajnimet në lëminë mbrojtjes nga zjarri dhe çertifikimin e tij nga AME në bazë të njohurive të fituara). - Në mbajtjen e trajnimeve përpilohet plani trajnues dhe mbahet evidencë e trajnimeve me nënshkrimet e punëtorëve që kanë marr pjesë në trajnim. Sigurohuni që të punësuarit kanë përfituar njohurit e nevojshme nëpërmjet testeve. Testimet teorike dhe praktike mbahen si dokumentacion).			
2.	A është bërë vlerësimi i riskut në vendin e punës, dhe a përfshihen në të rreziqet nga zjarri? Ligji Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 16. Rregullorja MPMS Nr.02/2016, neni 4.3.			

	- Kontrolloni nëse vlerësimi i riskut përmban analizë për rreziqet nga zjarri, masat mbrojtëse që duhet marrë (shembull: pajisja me aparatet për fikjen e zjarrit, instalimi i dedektorëve në objekte, instalimi i hidrantave etj.). - Kontrolloni nëse janë marrë masat e nevojshme për të shmangur ose zvogëluar risqet (siguroni që masat organizative ose teknike janë duke u zbatuar, plani trajnues mbahet dhe evidentohet, aparaturat dhe stabilimentet janë në kushte të mira dhe mirmbahen sipas planit.). - Në të gjitha objektet dhe vendet me rrezik vendosen shenja që ndalon konsumimin e duhanit, flaken e hapur. Inspektimi me praktikën e mira dhe praktikën jo të mira komunikohet me të punësuarit.   Ndalohet pirja e duhanit së hapur. Ndalohet pirja e duhanit dhe i flakes.			
3.	A është hartuar një plan për evakuimin dhe shpëtimin në situata emergjente? Ligji Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 11. - Sigurohuni që në planin e evakuimit është shënuar hirarkia e thirrjeve emergjente (numrat e kontaktit), diskutoni me të punësuarit dhe sigurohni që ata e kuptojnë dhe e dinë planin e veprimit në situata emergjente. - Kontaktet për thirrje në numrat emergjencës janë të ekspozuara në vende të ndryshme në vendin e punës dhe të dukshme. - Sigurohuni që plani i hartuar përfshin daljet emergjente dhe rrugët që të shpien deri tek daljet më të afërta për evakuim. - A janë parashikuar në planin e evakuimit pika e grumbullimit. (Sigurohuni që në punishte janë vlersuar dhe caktuar vendet e grumbullimit për raste emergjente, diskutoni me personelin dhe sigurohuni që ata e kuptojnë se çka është qëllimi i vendeve të grumbullimit si pikë takuese, dhe ku gjinden ato vende.). - Sigurohuni që të punësuarve u është ofruar trajnim i nevojshëm për evakuim emergjent në raste zjarri, mbani evidencën me nënshkrimet e punëtorëve që kanë marrë pjesë në trajnim.			

	<i>- Ushtrime praktike me të gjithë të punusarit të paktën një herë në dy (2) vjet, në përputhje me këtë plan, rezultatet e trajnimit evidentohen ne raport dhe për mangësit e evidentuara mirret veprime korrigjuese/përmirësuese.</i> <i>Shënim për pika e grumbullimit: personeli që dalin nga objekti për tu evakuar në raste emergjente duhet të grumbullohen në një pikë takuese e parashikuar dhe e vlersuar si e siguritë paraprakisht, zakonisht këto vende shenjohen me shenjë!</i>			
4.	Punët përfundimtare të sipërfaqeve vertikale dhe horizontale të daljeve dhe rrugëve dalëse në objekte, a janë të ndërtuara nga materiali me karakteristika rezistuese ndaj zjarrit? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 15, 29. <i>- Nga punëkryersi dhe prodhuesi kërkohen dhe sigurohen dëshmi për karakteristikat e materialit rezistues ndaj zjarrit, dokumentet ruhen në arkivë.</i> <i>- Pranimi teknik i objektit dhe materiali i përdorur gjatë ndërtimit bëhet sipas udhëzimeve të ligjit 04/L-012 neni 14.</i> <i>- Realizohet inspektim i gjitha objekteve, nëse kanë këto karakteristika.</i>			
5.	A janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të rregullt pajisjet, instalimet, ventilimet e gazrave, oxhaqet si dhe pajisjet e tjera, të cilat paraqesin rrezik për zgjerimin e zjarrit në harmoni me normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve për të cilat duhet të ketë dokumentacion? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 16. <i>- Sigurohuni që dokumentacionin për normativat teknike dhe udhëzimet e prodhuesve, janë zbatuar sipas udhëzimeve të tyre, gjithashtu janë rrespektuar distancat, materiali dhe mirëmbajtja e rregullt.</i> <i>- Sigurohuni që funksionaliteti i stabilimenteve të cekura më lartë bëhet nga stafi adekuat dhe marrveshja për rregullimine dhe funksionimin e tyre është rregulluar me kontratë për bartjen e përgjegjësi. Kontratat ruhen si dokument dëshmuar.</i>			
6.	A funksionojnë në gjendje të rregullt pajisjet stabile të destinuara për lajmërimin dhe fikjen e zjarrit, detektimin e gazrave dhe avujve të ndezshëm, si dhe pajimet tjera mbrojtëse dhe instalimeve të cilat shërbejnë për evitimin e shkaktimit dhe zgjerimin e zjarrit dhe shpërthimit? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 16, 17, 19, 29.			

	Udhëzimi Administrativ Nr.17/2017, neni 5, 7, 8, 9. - Sigurohuni që mirëmbajtja e pajisjeve është bërë të paktë (1) herë në vitë sipas udhëzimeve të prodhuesit të atyre pajisjeve nga punëtorë të kualifikuar dhe kjo qështje është e rregulluar edhe me kontratë. - Raporti i kontrollimit të stabilimenteve të cekura sipër mbahet. Vërejtjet e cekura në raportë janë zbatuar në vend për përmirsim të situates. - Kontrolloni të gjitha aparatet për fikjen e zjarrit, a janë në gjendje të rregullt dhe të etiketuar me etiketa informuese nga kompanitë e licencuar për servisim të aparateve për fikjen e zjarrit. Shënim: Kontrollini aparatet për fikjen e zjarrit bëhet çdo gjashtë (6) muaj dhe vendoset etiketa informuese nga kompanitë e licencuar për servisim të aparateve për fikjen e zjarrit.			
7.	A është instaluar rrjeti i brendshëm hidrantave nëse: • Është kërkuar me dispozita dhe kushte të veçanta nga lëmi e mbrojtjes nga zjarri? • Kërkohet me planin hapësinor? • Objektet të cilat me karakteristikat e veta bëjnë pjesë në kategorinë e I, II ose III të rrezikshmërisë nga zjarri? • Në garazhet dhe vendparkimet e objekteve sipërfaqja është më e madhe se 100 m²? • Etazhet nëntokësore kanë sipërfaqe më të madhe se 100 m²? • Ka punë të përhershëm me saldim të cilat gjenden në brendësi të objektit? • Tubohen numër i madh i njerëzve? Udhëzim Administrativ Nr.24/2012, neni 3, 6. - Sigurohuni që në vend - burimi i ujit të hidrantave ka shtypje të pandërprer të ujit së paku 60 minuta. Testoni atë nëpërmjet pajisjeve të përshtatshme dhe kompanive të licencuara për testim. Raportin e testimit ruhet dhe vërejtjet eliminohen / përmirsohen. - Inspektori dhe sigurori pastërtin e ujit (uji i cili shfrytëzohet nga burimi i sigurtë, nuk duhet të përmbaj papastërtira të cilat pengojnë funksionimin e duhur të rrjetit të hidrantëve për fikjen e zjarrit). Shënim: Shtypja në fiskajë gjatë rrjedhës së sasisë minimale të ujit nuk mund të jetë më e vogël se 0.25 Mpa (2.5 bar).			

	<i>Në qoftë se si burim i sigurtë i ujit shfrytëzohet rezervuari rrjedhës, atëherë sasia e ujit nuk duhet të jetë më pak se 1 m³.</i>			
8.	A është instaluar rrjeti i jashtëm i hidrantave nëse: • Është kërkuar me dispozita dhe kushte të veçanta nga lëmi e mbrojtjes nga zjarri? • Kërkohet me planin hapësinor? • Ka vende të banuara, të cilat kanë sistemin e furnizimit me ujë? • Objektet të cilat me karakteristikat e veta bëjnë pjesë në kategorinë e I, II ose III të rrezikshmërisë nga zjarri? Udhëzim Administrativ Nr.24/2012, neni 4, 6, 15, 18. - Sigurohuni që në vendin e burimit të ujit të hidrantave ka shtypje të pandërprer të ujit së paku 120 minuta nëpërmjet pajisjeve të përshtatshme dhe kompanive të licencuara për testim. Kërkoni raportin e testimit dhe vërejtjet merren parasysh për përmirsimin gjendjes. - Inspektori dhe sigurori pastërtin e ujit (uji i cili shfrytëzohet nga burimi i sigurt, nuk duhet të përmbaj papastërtira të cilat pengojnë funksionimin e duhur të rrjetit të hidrantëve për fikjen e zjarrit).			
9.	A janë hidrantët e murit të ngjyrosura me ngjyrë të kuqe, ku gjendet shenja në mënyrë të qartë e dukshme dhe në kuadër janë pajisjet e rrjetit të hidrantëve për fikjen e zjarrit? Udhëzim Administrativ Nr.24/2012- MPB. Neni 11, 20. Rregullorja MPMS Nr.04/2016, Aneksi I, neni 2.1.2, Aneksi IV. - Sigurohuni që shenjëzimi i hidrantave është bërë me simbolet sipas normës ISO 6309. - Hidrantët e murit që instalohen sipas normës EN 671–2 duhet të jenë të vendosura në dollapë të hidrantit së bashku me pajisje përcjellëse. - Vendi ku vendoset hidranti nëntokësor duhet të shenjëzohet në mënyrë të dukshme në harmoni me simbolet sipas normës teknike EN. 			

	Zorrë uji.			
10.	A është bërë testimi i rrjetit dhe pajisjeve të hidrantave? Udhëzim Administrativ Nr.24/2012- MPB. 18, 19, 22. - Sigurohuni që rrjeti i hidrantëve, me të gjitha pajisjet dhe armaturat është kontrolluar së paku një herë në vitë dhe për këtë është përgaditur raporti i testimit. Vërejtjet e konstatuar në atë raport (magësit, rrjedhjet gjatë testimit) janë eliminuar me kohë, dhe raport tjetër është përgaditur pas përmirsimit të situates. Shënim: Shtypja statike në rrjetin e jashtëm të hidrantëve për fikjen e zjarreve nuk duhet të jetë më e madhe se 1,2 Mpa (12 bar). Te rrjeti i jashtëm i hidrantëve për fikjen e zjarrit nuk duhet të vij deri te rrjedhja e ujit gjatë testimit provues të shtypjes prej 1.6 Mpa (16 bar), as te pëlcitja në shtypje prej 2.4 Mpa (24 bar) Shtypja më e ultë e ujit në dalje nga cilido hidrant mbitokësor ose nëntokësor të rrjetit të jashtëm të hidrantëve për fikjen e zjarrit, nuk duhet të jetë më e ulët se 0.25 Mpa (2.5 bar) te rrjedha e paraparë e ujit.			
INSPEKTIMI I VENDPUNISHTEVE / VENDEVE TË PUNËS				
	* Gjatë vizitës në vendet e punës, do t'ju duhet të mbani shënime. Është më e lehtë të mbahen shënime të strukturuar. Për shembull, përdorni formularët e inspektimit. Merrini me vete. Përmbajtja e formularëve të inspektimit varet nga vendi i punës që do të vizitoni. Nëse nuk keni formularë inspektimi, mbani vetë shënime të mira dhe lehtësisht të kuptueshme (p.sh. duhet të përfshihet vendi i inspektimit, data/ora, ekipi i inspektimit, të punësuarit vendet me rrezik të ndezjes së zjarrit, aparatet për fikjen e zjarrit, PPM-të që kërkohen për të kryer detyrën/punën, etj.). * Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në mënyrë të përshtatshme në lokacion / vendet e punës. * Gjatë vizitës në lokacion / vendin e punës kushtoni vëmendje nëse stabilimentet dhe aparatet për fikjen e zjarrit, a janë në kushte të mira dhe të kontrolluara. * Vëzhgoni dhe sigurohuni që ndiqen procedurat standarde të funksionimit. * Bisedoni me punonjësit në mënyrë miqësore dhe shpjegoni dhe këshillojini ata mbi rregullat e përgjithshme për mbrojtje nga zjarri. * Pas vizitës së realizuar shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe të këqija nga vizita juaj në lokacion.			

	<i>* Në rastet e mangësive të vëzhguara, sqaroni situatën dhe rëndësin e të qenurit në gadishmëri për të reaguar dhe përgjigjur situatave emergjente.</i>			
11.	Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, a posedojnë pajisjet, mjetet dhe stabilimentet për fikjen e zjarrit? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 19, 5, 29. Udhëzim Administrativ Nr.17/2017, neni 5, 7, 8, 9. Rregullorja MPMS Nr.04/2016, Aneksi I, neni 2.1.2, Aneksi IV - Sigurohuni që pajisjet dhe mjetet për fikje të zjarrit, shfrytëzohen vetëm sipas dedikimit, dhe mirëmbahen në gjendje të rregullt, posaçërisht të shënuar dhe të gatëshme për përdorim. - Kontrollimi dhe servisimi i rregullt aparateve për fikje të zjarrit, a bëhet nga personat e autorizuar, të cilët janë teknikisht dhe profesionalisht të aftësuar, në bazë të autorizimeve të Ministrisë-Agjencisë. Sigurohuni që marrveshjet janë finalizuar me kontratë. - Sigurohuni që objektet janë të furnizuar me sasinë e mjaftueshme të aparateve për fikjen e zjarrit. Objektet janë të pajisur me dedektor për alarmim të zjarrit dhe testohen rregullisht nëpërmjet stafit apo kompanive kompetente. Raportet e testimit ruhen, ndërsa për vërejtjet merren masa korigjuese/përmirësuese. - Diskutoni dhe trajtoni të punësuarit për reagim në raste emergjente, sigurohuni që kanë informatën e nevojshme dhe aftësin për të reaguar. - Verifikoni, a janë realizuar kontrole të rregullta të aparateve për fikje të zjarrit. Sipas udhëzimeve të prodhuesit bëhet të paktën një herë në çdo muaj. Ndërsa nga kompanit e licencuar sipas ligjit bëhet çdo (6) gjashtë muaj. - Aparatet për fikjen e zjarrit të cilave ju ka rënë shtypja para afatit 6 muaj, apo janë dëmtuar, njoftohet kompania e licencuar për zëvendësimin apo servisimin e tyre në kohë. - Sigurohuni që aparatet të cilat përdoren nuk kthehen në vendin e mëparshëm pa u servisuar paraprakisht. - Verifikoni shenjëzimin e aparateve për fikjen e zjarrit. Nëse mungon shenjëzimi merren masa për vendosjen e tyre, Shikoni një shenjë që vendoset sipër aparateve për fikjen e zjarrit.			



Fikës zjarri

12. **A janë marrë masat e nevojshme nga punëdhënsi për aftësimin dhe trajnimin e të punsuarve për fikjen e zjarrit?**

Ligji Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 11.

- Sigurohet që në vendine punës përmes broshurave, posterave, tabelave informuese, trajnimeve, të punësuarit marrin informacionin (të shkruar i përgjithshëm dhe specifik) me udhëzimet e nevojshme për mbrojtje nga zjarri dhe fikje të zjarrit.
- Shikoni në vend, a janë të postuara në tabelat informuese posterat dhe udhëzimet e nevojshme.
- Diskutoni me të punësuarit dhe sigurohuni që ata e kanë mbajtur trajnimet në mënyrë teorike dhe praktike për mbrojtje nga zjarri. Pas trajnimeve janë mbajtur testime ku merret informacioni për arritshmerin dhe të kuptuarit të tyre /vlersohet.
- Kontrolloni nëse informacioni specifik për trajnim (nëse aplikohet) përfshin:
 - Kategorit e zjarreve në klasa (A, B, C, D, E)
 - Tipet e aparateve për fikjere zjarrit etj.

13. **Hartimi i planit për evakuim emergjent, a përfshin masat e nevojshme të mbrojtjes dhe shpëtimit në rast zjarri?**

Ligji Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, neni 11.

- Sigurohuni që objektet janë pajisur me planin e evakuimit emergjent dhe në të janë shënuar kjo numrat e thirrjeve emergjente. Diskutoni me të punësuarit dhe sigurohuni që ata e kuptojnë dhe e dinë planin e veprimit në situata emergjente.
- Verifikoni, nëse të punësuarit kanë marrë pjesë në trajnimin praktik gjatë simulimit dhe evakuimit në rastet e zjarrit.

	- Verifikoni që në planin e evakuimit janë përfshi daljet emergjente dhe rrugët që duhet ndjekur për evakuim.			
14.	Proceset teknologjike në të cilat shfrytëzohen apo prodhohen fluidet, gazrat e ndezshme apo materiet shpërthyes, a kryhen vetëm në objektet ose pjesët e tyre, të cilat janë të ndara nga pjesët e tjera prodhuese dhe depozituese, objekte të pajisura me pengesa rezistuese ndaj zjarrit që pamundësojnë përhapjen e zjarrit? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 22, 17, 15, 29. Rregullorja MPMS Nr.02/2016, neni 4.3. - Sigurohuni që është bërë ndarja e objekteve ose pjesëve të tyre nga proceset të cilat mund të krijojnë ambient shpërthyes apo lehtë-ndezës, apo gjitha punët kryhen në objektet e ndara. - Dyert dhe muret, a janë të ndërtuara nga materiali zjarr durues (kërkoni nga ofruesi i shërbimit raportin që garanton se dyert dhe muret kanë këto specifika dhe në raportin teknik janë të cekura.). - Verifikoni dhe sigurohuni që aktivitetet me flake të hapur në afërsi të fluideve dhe gazrave të ndezshme, materieve shpërthyes dhe të tjera, të cilat mund të shkaktojnë zjarr, organizohen në atë mënyrë që rreziku nga zjarri të mënjanohet, respektivisht të bie në masën më të vogël, varësisht nga natyra dhe kushtet e punës., nëse gjatë inspektimit vërehen keq-organizime merren masa përmirsuese. - Mjete dhe stabilimente për fikjen e zjarrit në objekte, janë të pranishëm në sasi të mjaftueshme dhe të kontrolluara. - Lëndët të cilat paraqesin rrezik për shkaktimin dhe përhapjen e zjarrit, apo janë të vendosura në vende të ndaluara, duhet të largohen nga objektet apo mjedisi në vazhdimsi. - Sigurohuni që në vendin e punës janë të postuara udhëzimet për punë të sigurtë dhe mbrojtje nga zjarri. - Sigurohuni që në objekte janë të vendosura shenjat ndaluese që ndalohet flaka e hapur dhe konsumimi i duhanit.			



Ndalohet pirja e duhanit.



Ndalohet pirja e duhanit dhe i flakes së hapur.


15. Objektet apo pjesët e objekteve, a posedojnë dyer për dalje emergjente për mundësimin e daljes së shpejtë të personave në rast zjarri?

Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 29, 1.7.


Rregullore nr 24/2012. Neni 33, 38.

Rregullorja MPMS Nr.04/2016, Aneksi I i neni 2.1.1.


- *Dyert duhet të jenë të vendosura në mënyrë që në çdo kohë mund të hapen nga ana e cila duhet të dalim. Testoni dyert a hapen papengesa dhe në kahun e daljes.*
- *Shenjat për dalje emergjente me ndriçim duhet të ndriçon dritë me forcë së paku 50 lx.*
- *Kontrolloni nëse dyert për dalje emergjente dhe koridoret pengohen nga gjësende të deponuara në koridore, organizoni pastrim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme.*
- *Shiko dyert, a janë shenjësuar me shenja të dukshme emergjente që tregojnë rrugë-kalimin, ndersa koridoret me shenja treguese me shigjeta që tregojnë shtigjet e daljeve që të shpien tek daljet emergjente; shiko më poshtë disa shembuj:*



- *Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për rrugët e daljes emergjente nga disa pika të lokacionit. Ecni nëpër 2-3 rrugë të daljes emergjente për të identifikuar nëse mund të arrini në një pikë të sigurt takimi vetëm duke ndjekur shenjat e sigurisë. Në rrugën tuaj mund të kontrolloni edhe nëse rrugët e daljes janë të lira, mjaftueshëm të gjera, dyert nuk janë të kyçura ose bllokuara etj.*

16.	A janë marr masat e nevojshme për parandalimin e ndezjes së zjarrit përshkak shkëndijave të cilat automjetet mund t'i shkaktjnë gjatë afrimit, apo instalimet dhe pajisjet, të cilat gjatë punës mund të shkaktjnë zjarr? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, neni 29 Rregullorja MPMS Nr.04/2016, Aneksi I, neni 2.1.4 dhe shtojca V. - A është pamundësuar afrimi i automjeteve apo makinerive tek zonat me ndieshmeri të lartë të ndezjes së zjarrit. Shembull a janë vendosur e pengesa në rrugë shenja paralajmruese që parandalon një gjë të tillë, shembull disa shenja shiko me poshte. - A është pamundësuar hedhja nga jashtë të sendeve, të cilat do të mund të shkaktjnë zjarrë (verifiko dritaret apo dyert, a janë të kufizuar permanent, rrobat të cilat përdoren nga personeli në këtë zonë, a janë anti-statik apo që nuk krijojnë elektricitet static. - Janë vendosur shenja ndalohet flaka e hapur, ndalohet konsumimi i duhanit. - Është vendosur shenja vend me rrezikshmëri të lartë të ndezjes. - Personeli e ka njohurine rrezikut dhe në trajnimet e mbajtura, është theksuar kjo qështje. - Gjitha instalimet dhe pajisjet janë të atilla që nuk krijojnë shkëndia zjarri. Instalimet kontrollohen dhe atestohen rregullisht në mënyrë adekuate. - Shikoni në fund të listës inspektuese janë paraqitur shenjat për paralajmrim, shenjat për ndalim shenjat obligative etj. Shembull shenjave:   Material e ndezshëm ose Material shpërthyes rrezikshme temperaturë e lartë. Shenja për lokacionet e përplasja me pengesa apo rënje e objekteve.			
17.	A është sipërfaqja përreth hidrantëve e lirë dhe e pastruar, ashtu që hidrantët të jenë gjithmonë të dukshëm dhe gatshëm për përdorim?			

	Udhëzimi Administrativ Nr.24/2012, neni 10. - <i>Sipërfaqja ku hidrantët e brendeshem dhe të jashtme janë të instaluar duhet gjithëher të jetë e lirë dhe pa pengesa.</i> - <i>Shiko, nëse janë të dukshme në vendin se ku janë të instaluar.</i> - <i>Shikoni hidrantat, a i posedojnë pajisjet e nevojshme për intervenim (a janë në gadishmëri fiskajet, zorrët etj.).</i>			
18.	Distanca më e largët e hidrantit jashtë objektit, a është maksimumi 80 metra larg, ndërsa afërsia me objektin maksimumi 5 metra? Udhëzimi Administrativ Nr.24/2012, neni 15, 16. - <i>Verifikoni planin e instalimit, a është sipas udhëzimeve administrative, nëse nuk janë sipas këtyre specifikimeve, konsultohuni mbase mund të merren masa organizative apo teknike për rregullimine gjendjes.</i> <i>Shënim shtesë: Në vendbanimet me shtëpi familjare, distanca ndërmjet dy hidrantëve të jashtëm fqinjë nuk duhet të tejkalojë më shumë se 300 m.</i> <i>Largësia ndërmjet dy hidrantëve të jashtëm fqinjë nuk duhet të jetë më e madhe se 150 m, në qoftë se me udhëzim të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.</i>			
19.	A është bërë testimi i rrjetit dhe pajisjeve të hidrantave të paktën një (1) herë në vitë? Udhëzimi Administrativ Nr.24/2012, neni 22. - <i>Shikoni në raportin e testimit nëse pajisjet e hidrantit kishin mangësi dhe shikoni në vend a janë eliminuar gjetjet.</i> - <i>Shiko nëse ka plasaritje në zorrën e hidrantit dhe në fiskaje.</i> - <i>Inspekto hidrantin e testuar nëse përputhet me karakteristikat e cekura në raport.</i> - <i>Gjitha vërejtjet e cekura sipër merren parasysh dhe eliminohen me kohë.</i>			
20.	Tek pajisjet zjarrfikëse, a janë vendosur shënime të përhershme me tabela dhe/ose ngjyra të sigurisë me të kuqe? Rregullorja MPMS Nr.04/2016, Aneksi I, neni 2.1.2, Aneksi IV. - <i>Kontrolloni 2-3 vende me pajisje zjarrfikëse nëse këto vende janë shënuar.</i>			

		<i>Zorrë uji</i>						
		<i>Shkallë</i>						
		<i>Fikës zjarri</i>						
		<i>Telefon alarmi zjarri</i>						
		<i>Kënde</i> j (shenjë informacioni plotësues) <i>Kjo shenjë përdoret për të treguar drejtimin në vendet ku mbahen pajisjet për zjarrfikje, ose pikat e tyre të hyrjes.</i>						
<i>- Nëse vërhen që mungojnë shenjat apo janë dëmtuara, merren masa për instalimin e tyre.</i>								
21.	A janë shënuar objektet me shenja të ndihmës së parë? Rrequllorja MPMS Nr.04/2016, Aneksi i neni 2.1.1.							

- Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit. Nëse nuk mund t'i shihni shenjat, pyesni 2-3 punëtorë nëse e dinë ku ndodhen objektet e ndihmës së parë.



Stacioni i ndihmës së parë



Barela



Dushi i sigurisë



Larja e syve



Telefon emergjent për ndihmë të parë ose shpëtim



*Këndeje (shenjë informacioni plotësues)
Kjo shenjë përdoret për të treguar drejtimin në vendet ku mbahen pajisjet e ndihmës së parë, ose pikat e tyre të hyrjes.*

	- Nëse nuk mund të gjenden shenja për ndihmën e parë apo janë të dëmtuara, merrni masat e nevojshme për instalimine tyre.			
22.	A janë vendosur shenjat e sigurisë në përputhje me vlerësimin e riskut në vendin e punës? Rregullorja MPMS Nr.02/2016, neni 4.3. - Kontrolloni nëse shenjat janë në përputhje me vlerësimin e riskut, sigurohuni që ato janë në vende adekuate. - Sigurohuni që shenjat e dëmtuara apo që mungojnë, bëhet zëvendësimi apo instalimi i tyre rregullisht.			